



Asambleja
01.Nr.XI
Deçan,dt.29.12.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e XI-të, të rregullt të Kuvendit, me dt.29.12.2023.

Në mbledhje ishin prezent:23 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale (10).

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit të transportit rrugor lokal për Komunën e Deçanit 2023-2028;
4. Shqyrtimi dhe miratimi I draft- Programit për banim social 2023-2026 ,
5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga vërshimet, breshëri, erërat, etj.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar,
8. Marrja e vendimit për hartimin e Planit rregullues për pronat e shpallura me interes public në parkun kombëtarë “ Bjeshkët e Nemura”,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës rezervë për emërimet të rrugëve nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Deçanit,
10. Shqyrtimi i Draft- Raportit të performancës komunale për vitin 2022,
11. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe planit të veprimit 2023-2030,
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024,
13. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e XI-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 23 anëtarë të kuvendit (mungojnë: Hamid Zukaj, Afrim Demhasaj, Hyri Dobrunaj dhe Shkelqim Tolaj).

Në vazhdim kryesuesi e prezantoi rendin e punës të propozuar me ftesë, pastaj e hapi debatin rreth rendit të punës.

Vatan Istrefaj –siç e kemi parë në planin e punës në muajin nëntor ka pasë me ardhë raporti i auditorit të jashtëm, por meqenëse nuk ka ardhë në nëntor pse nuk ka ardhë në muajin dhjetor raporti i auditorit të jashtëm, si dhe po ti shohim po ashtu këto pika shtesë që kanë ardhë jasht rendit të ditës është mirë që mos të përdoret një praktikë e tillë edhe për shkak se është një rend i ditës i ngarkuar sot, për shkak të pikave të shumta që kanë mbete materiali është dashtë me ardhë me kohë për pikat e propozuara shtesë.

Mon Selmonaj- propozoj që pika 10- Shqyrtimi i Draft- Raportit të performancës komunale për vitin 2022, të hiqet nga rendi i ditës me arsyetim sepse nuk lexohet materiali që posedoj unë , mirëpo nëse kolegët tjerë nuk e kanë këtë mangësi, atëherë e mbështes këtë pikë dhe pajtohem që të shqyrtohet.

Teuta Neziraj- edhe unë dashta me ngritë të njëjtën çështje si baci Mon, se edhe mu me ka ardhë pika e 10 si material i pa lexueshëm.

Florim Mataj – thotë se pika 9 është larguar nga rendi i ditës me rekomandim të KPF, për të cilën rekomandohet që të hiqet edhe nga rendi ditës mbledhjes së Kuvendit.

Albesa Cacaj- kam një sqarim ose përmirësim në qofte se mundemi ta quajmë, te pika 10 është emërtim i gabuar sepse nuk është Draft siç është emërtuar por është raport që sot ka mu shqyrtu, nuk ka mu votu se ky nuk votohet asnjëherë, thjeshtë te emërtimi e kam fjalën, që duhet të emërtohet Raporti i performancës komunale.

Hajdar Sutaj- sa i përket çështjes së ngritur nga Vatani- raportit të auditorit të jashtëm është diskutuar në qershor, ndërsa sa i përket kërkesës së Mon Selmanaj për material, po shihet se shumica ka qenë në rregull vetëm dy raste është si i pa kuptuar. Kryesuesi ka thënë duke u larguar pika 9. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës rezervë për emërtime të rrugëve nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Deçanit, dhe duke e prezantuar për diskutim:

Marrja e Vendimit përfundimtar për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, parcela nr.0429-0, Zk.Deçan, aprovimi i ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues.

Ju kisha lut për votim të rendit të punës, ku konstaton në vazhdim se unanimisht kalon rendi i punës.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika I aprovohet, konstatohet që unanimisht kalon procesverbali i mbledhjes së kaluar.

II. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit.

Leotrim Hadergjonaj- në emër të grupit të AAK-së ka thënë se ne si grup pajtohemi me këtë raport.

Blinera Lokaj, sa i përket planit të integritetit vërejmë se ekzistojnë disa dukuri jo të mira në komunën tonë kryesisht në aspekte organizative, ka raste se nuk dihet mirë se kush është përgjegjës për detyrat e caktuara brenda një fushe të caktuar, po ashtu në pyetjen e pestë, a ekziston kontroll i vazhduar mbi zbatimin e detyrave, një numër i madh i zyrtarëve komunal janë përgjigje, jo, gjithmonë dhe rrallëherë ushtrohet një kontroll i tillë, ndërsa sa i përket Kodit të atikes-kodi i etikës ekziston, mirëpo ky kod a zbatohet në punën tuaj të përditshme, ku vetëm 52% të zyrtarëve janë përgjigje-po, me qenë se ky plan është i rëndësishëm për komunën tonë, cilët janë mekanizmat e juaj që do të përdorni për ta përmirësuar zbatimin e këtij plani dhe sa herë në vit parashikoni të mbani trajnim dhe punëtori në bashkëpunim me MAPL për trajnim të zyrtarëve komunal

Orges Tafilaj, në krahasim me raportin e kaluar plani i integritetit është i përmirësuar për ndryshim prej kolegëve mendoj që anketa të përfshinte një numër të madh të pyetjeve, dhe meqenëse herën e kaluar raporti ishte i nivelit shumë të ulët dhe përgjigja estafit ndaj pyetjeve që i janë drejtuar atëherë ishin pothuajse edhe skandaloze, dhe pyetja që parashtrohet është çka ka ndodhur gjatë kësaj kohe, ka pase testim, kase trajnime të stafit apo diçka tjetër, po ashtu besoj se rezultati i mirë në disa pyetje është si rezultat i mënyrës së pyetjeve që janë parashtruar, pajtohem me Blinere që 42 % e stafit akoma nuk mendojnë që kodi etik i zgjidh plotësisht ose hiq dilemat etike, ndërsa te pyetja e 7, ku 75 % e stafit është përgjigje po, nuk mund të paragjykoj është 15% ndërsa pjesa tjetër nuk është askund, besoj që nuk është në përgjithësi si jo atëherë duhet të jete në një nga këto dy opsione besoj se gjë e mirë është që një pjesë e madhe e stafit, me tepër se gjysma e stafit janë me tepër se 10 vite me përvojë në punë, megjithatë besoj që trajnimet dhe testimet e vazhdueshme duhet të vazhdojnë në mënyrë që të jenë në përputhje me integritetin.

Mon Selmanaj, në hyrje të këtij plani hartuesi i tij na ofron në mënyrë të qartë rritje të objektivave dhe qëllimit për fuqizimin e sundimit të ligjit, ky plan na paraqet përkushtimin e komunës për kontrolle operative dhe për tu fokusuar në shërbime efikase dhe transparente, gjë që len shumë për të dëshiruar në këtë aspekt, në fq. 5 të këtij plani ku përshkruhen hapat e realizimit të këtij raporti e ku thuhet se janë shpërndarë pyetësorë dhe janë intervistuar zyrtar publik ku sipas meje është dashtë të ipen shifra të sakta për drejtorin dhe për zyrtarë sespe rezultatet e anketimeve të cilat na janë prezentua do të ishin shumë ma bindëse si psh në fq.7 ku e potencoj edhe kolegu parafolës ku një përqindje nuk e përfshinë masën 100 % dhe të kishte qenë mirë që hartuesi i këtij raporti të na sqaroj, këtu mu besoj që është bere një lëshim sepse nuk është dhënë numri i sakt i të anketuarve për secilën pyetje

veç e veç, në mënyrë që anketimi të jetë edhe më i besueshëm edhe në përqindje, dhe në fund pajtohem plotësisht me rekomandimet e dhëna në mënyrë që plani të bëhet edhe më i zbatueshëm. Ajne Iberhysaj, se cila nga vërejtjet dhe plotësimet e juaja për mua janë të mirëseardhura megjithatë sa i përket trajnimit dhe kodit të etikës në të cilën u cek që është dal nga anketa do ta marrim përsipër sepse në vitin 2024 do të do të kemi kërkesë nga niveli qendror për mbajtjen e trajnimeve për stafet në të cilët janë stafi i ri i pranuar në Komunë, ndërsa sa ju përket të tjerave që janë të domosdoshme që u cekën nga diskutuesit këtu janë të mirëseardhura dhe do të jenë të përfshira në raportin e ardhshëm për vitin 2024.

Kryesuesi e mbylli debatin rreth kësaj pike.

III. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit të transportit rrugor lokal për Komunën e Deçanit 2023-2028.

Miftar Ahmetxhekaj, edhe pse me dëshirë për të trajtuar këtë dokument do të ishte dhe ka qenë dashur edhe kryetari me qenë prezent, material i cili është trajtuar edhe në seancën e kaluar ku edhe në seancën e kaluar kam pas vërejtje, është dokument që ky ka synime është dokument që pretendon me pasë zhvillim në infrastrukturë edhe pse kisha dëshirë me qenë kryetari këtu por prezent është drejtori urbanizimit për të dhënë sqarime, në në fq. 6 ka konstatim se rrjeti i rrugëve të Deçanit është i dobët ose nuk është i mirë pse ka ndodhur kjo, dhe e dyta ku trajtohet rrethi apo qendra e Deçanit, a ka paralogari cila është kostoja financiare e këtij projekti, a ka projekt ideor dhe sa është zbatues, dhe a është pagu ky projekt, çka nëse nuk gjenë zbatueshmëri, e treta çka është prioritet për komunën e Deçanit, a ka Deçani projekte të tjera të cilat janë jetike psh. A mendohet të investohet në kanalizime, në ujera të zeza, unë e kuptoj që ky dokument ka të bëjë me transportin, dhe i kemi tri forma të transportit, me autobus, minibus dhe me vetura, dhe nuk kemi stacion të autobusve, rruga prej qendrës së Deçanit deri të rruga e gashit nuk ka pika ndalesë dhe si kini me të trajtu këto, flitet për Deçanin ekologjik projekti është ku rruga qendrore ta ndanë Deçanin, koncentrimi i mjeteve prej të gjitha shtigjeve që hyjnë në Deçan dhe a mund të jete vend ekologjik ku do të kete transport me peshë të rëndë, kjo i ka tri skenarë, e para është zhvendosja e Mullirit të Shabanaj, pyetja ime është çka do të bëhet me Mullirin e Shabanaj si kini mi trajtu, pyetja e dytë është për një objekt që nuk është në kompetencë të menaxhimit nga komuna objekti i gjykatës, çka do të bëhet me objektin e Gjykatës sepse është objekt i KGJK-së, nuk ka tri katër vite që është ndertu objekti i qendrës së regjistrimit dhe jo vetëm Deçani por edhe komunat tjera kanë probleme me projekte afatgjate dhe është mirë të bëhen projekte afatgjate dhe jo prish sot e maro nesër.

Hajdar Sutaj, janë prezent zyrtaret e drejtorisë për Shërbime Publike të cilët do të japin sqarime.

Orges Tafilaj, ky plan është 4 vjeçar dhe duke marrë parasysh obligimet financiare për projektet që janë paraqitur unë besoj se është vështirë e realizueshme, poashtu janë paraqitur problematika të caktuara mirëpo nuk është parapare zgjidhje, për problematike është edhe sinjalizimi vertikal dhe horizontal i vjetruar por askush nuk ka përmendur se cila është zgjidhja e saj, ndërsa të trafikës këmbësor akoma kemi mungesë të madhe të trotuareve që paraqet rrezik për këmbësoret, rast konkret edhe rruga "Elez Geci e Maxhun Berisha" ku kemi raste të shumta të aksidenteve dhe cila është zgjidhja a do mbesim prap pa trotuare, pastaj për një funksionalizim të mirë të transportit në Deçan është e nevojshme edhe stacioni i autobusve, kurë dhe ku do të bëhet ndërtimi i një stacioni të mirfillte të autobusëve në Deçan.

Yllarta Thaqi, nëse duhet të votohet vetëm si dokument e votojmë, ama nuk kanë ardhur rekomandimet nga dëgjimet publike, edhe rekomandimet e mbledhjes së kaluar nuk janë përfshirë asnjë, për të gjitha këto plani është pak skeptik në realizimin e tij.

Ramë Melaj, përgjigje për Miftar Ahmetxhekaj, fjala është fillimisht për qendër të qytetit ku është një procedurë e bazuar në ligj, fillimisht e kemi pasur një konkurs për një projekt ideor është bërë për qendër ku është bërë nga prof., të Shqipërisë dhe Kosovës ku është hartuar projekti ideor, pastaj është hartuar edhe projekti zbatues ku prashihet që qendra e qytetit të lirohet nga objektet që kemi si, Objekti i Komunës, Pallati i Kulturës, objekti i Regjistrimit civil dhe objekti i Gjykatës, në projekt është menduar që qendra e qytetit të jete e hapur për lëvizje për qytetarë e jo për automjete dhe një parking nëntokësor me kapacitete 600 vendparkime ku si projekt zbatues nuk është në total i

përfunduar për shkak të pagesës., ndërsa stacioni i autobusëve, në i kemi dy pika në qendër dhe në Insiq ka tek Balajt, ndërsa sa i përket stacionit të autobusëve në qytete është paraparë në PZHK ku aktualisht hapsira e stacionit të autobusëve është kontestues, sa i përket Mullit është në listën e trashëgimisë dhe janë marrë hapat për zhvendosje dhe është caktuar si vend i vendosjes të pallatit të kulturës ndërsa sa i përket dislokimit të objekteve kemi diskutuar me të gjitha institucionet përkatëse ku hapësira për ndërtim të objektit të gjykatës do të caktohet me vendim të kuvendit, pyetje tjetër.

Miftar Ahmetxhekaj dilema nuk është të projektet por të realizimi i këtij projekti, secili projekt që duhet të bëhet duhet të bazohet në gjendjen ekzistuese, sa i përket mullirit Shabanaj është Ligji për trashëgimi kulturore i cili e ndalon dislokimin ku e ndalon pika 6 e ligjit dhe në momentin që e ndalon ai objekt e humbë kuptimin e rëndësisë kulturore, historike dhe arkitektonike, këtu i kam dilemat, projekt duhet të bazohet në gjendje ekzistuese, në gjendjen faktike që e ka në terren dhe në terren ku thotë ju nuk mund të ndërthohen këto projektet dhe nuk keni sponsorizues por të paktën ju jini zbatues të këtij projekti.

Ramë Melaj në kontakt me ministrin e kulturës dhe është e vertetë ajo çka potencuat ju mirëpo me vendim politik ministri kish mundësi për zgjidhje, është e vertetë që ka një vlerë historike mulliri aty por është shumë penguese, po është e pamundur realizimi i projektit këtu si është, mendoj që është jetike për Deçanin realizimi i këtij projekti, skema që prezentojmë si komune ku nuk kemi asnjë zhvillim të mirëfillt për këto financat janë kalkuluar parametat, dhe na ku nuk do të ndalemi.

Miftar Ahmetxhekaj sa është kostoja financiare.

Ramë Melaj komplet është mbi 22 milion.

Miftari nuk është zhvendosja vendimi imi personal.

Abesa Cacaj, dua të drejtohem drejtorit Ramë Melaj, ka 25 vite afërsisht nga mbarimi i luftës dhe komuna nuk ka stacion të autobusëve ku disa here është ngritë si çështje asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje ku potencioni se stacioni i autobusëve është kontest gjuqësor, atëherë pyetja ime është ku bëni qëdo vit komuna bënë shpallje të pronave të palujtshme dhe a nuk është e mundur gjetja e një vendi për stacion të autobusëve.

Ramë Melaj nuk mund të vendosim ku të kemi dëshirë, por duhet ta gjejmë pozitën më të volitshme, pozita më e mirë është aty ku ka qene, mirëpo për momentin është kontest gjyqësor.

Kryesuesi e qiti në votim planin me ndryshimet ndryshime, me shumicë votash miratohet, rezultati i votimit ishte me 12 vota për, 6 kundër (ldk dhe pdk) dhe 3 abstencione (vv).

IV. 4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft- Programit për banim social 2023-2026.

Vatani Istrefaj, si draft është diskutuar edhe në KPF ku kemi diskutuar, si grup parlamentar në kemi kërkuar disa here të dhëna rreth asaj se kush banon në ato banime sociale dhe nuk kanë ardhur ende, poashtu 32 kërkesa po shihet se kanë ardhur brenda këtij viti dhe janë për krahe këto 32 kërkesa, sa janë për krahe janë të gjitha a po pjesërisht.

Orges Tafilaj, sa i përket për të gjitha planet kur ipen verjtjet është mirë që verjtjet tona të përshihen në të, po them këto sepse edhe këto draft plan kur e kemi diskutuar realisht kam pasqyruar në fq. 30 të tabelës, ku thotë familjet me të ardhura mbi kufirin minimal mbi 150 euro pastaj vazhdon familjet me të ardhura mbi 150- 250, familjet me të ardhura prej 250 deri në 350, familjet nën kufirin minimal matematikisht është sxxx sepse edhe 150 deri 250 është mbi atë kufirin mbi 250 dhe tash ose duhet të heket ose duhet të vendoset fillimisht që nën këto kufi dhe pastaj kjo 2.4 të eliminohet, sa i përket sektorit të banimit sikurse sektori menaxhimit të mbeturinave a po shkohet drejt themelimit të një ndërmarrje publike banesore apo jo, kërkesa që e kam shtruar edhe herën e fundit por që nuk kam marrë përgjigje.

Mon Selmonaj, një pyetje për drejtoreshën fq. 30 pika 19 kritere për përcaktimin e radhës së përparësisë paragrafi 1.1 thuhet familjet që jetojnë në objekte të rrezikshme ose të pa përshtatshme për banim dhe kjo fjalë bjen nënshprehur pjesë e parë me pjesën e dytë të fjalës, a është kjo një gabim teknik apo si e interpretoni.

Agnesa Vokshi, po filloj me pyetje të 1 që bëri Vatani, se pari të dhënat që janë kërkuar të dhënat për banim social nuk është e ertet që nuk i kemi sepse e kemi parë listën këtu ku është dërguar lista me

emra, nga 32 kërkesa që janë bere se pari duhet theksur se objekti që është për banim social është i mbushur me familje dhe nuk ka vende të lira ndërsa, ne sa ju ndihmoj si komune subvencionohen familjet në nevojë për qerane, pyetja nga Orgesi kriteret janë marre nga ligji, e para ke të kufiri i të adhurave dhe e dyta a po shkohet nga një themelimi i ndërmarrjes banesore po e theksoj se kriteret që janë të cekura janë të ligjit, për financim jo vetëm në Deçan po në të gjitha komunat nuk ka kod për banim social ku nuk kemi mjete të mjaftueshme, ku nuk kemi ndonjë shumë të madhe ku ndahet nga qeveria dhe po penalizohem, gjithashtu potencoj se ndoshta kemi bënë ndonjë gabim teknik mirëpo kriteret i kemi shkruar sipas ligjit.,

Yllarta Thaqi, dy pyetje për drejtoreshën, edhe në KPF kemi cek se në hartimin e këtij draft programi komisionet apo grupet punuese është dashtë me qene pak ma gjithëpërfshirëse sepse e keni anashkalu në këto rast edhe QPS-në edhe OJQ ndërsa pas miratimit të këtij draft dokumenti a mendoni të bëni një komision të veçantë me baze verifikimit e këtyre banesave dhe me pa se kush duhet të shfrytëzon dhe kush duhet të largohet nga këto banesa, sepse jemi 25 vite pas lufte dhe ndoshta edhe ka keqpërdorime.

Drejtoresha Agnesa Vokshi- thotë se i kam parasyshë vërejtjet dhe sugjerimet që u bënë këtu dhe pajtohem që duhet të bashkëpunojmë me QPS-në dhe OJQ_të, dhe sa i përket komisionit edhe unë pajtohem.

Faton Selmanaj, pata 2 pyetje e para është se a i plotësojnë kriteret çdo banor që shfrytëzon ato banesa dhe e dyta puna e subvencionit sa familje janë subvencionuar dhe a janë subvencionuar me përqindje apo në tërësi.

Agnesa Vokshi- sa i përket pyetjes se a i plotësojnë kriteret familjet që janë aty, komisionet paraprake e kanë bërë verifikimin e kriterëve të tyre dhe pa dyshim që, po, i plotësojnë, dhe me arsye kolegjia jone e ngriti çështjen e komisionit dhe tash ndoshta duhet formu një komision i ri dhe sakt me pa se kush i plotëson kushtet tash për strehim aty, ndërsa sa i përket subvencionimit Zyra e kryetarit i subvencionon familjet me nevojë, ku disa familjeve ju ka subvencionu komplet qeraja ndërsa disa prej tyre 50 % dhe kjo varësisht nga gjendja ekonomike e tyre.

Akbesa Cacaj, tek fq, 27 për strehim është parapare që nga viti 2018, meqë ky është plan që parashihet të implementohet gjatë tri viteve të radhshme dhe nuk pashë që kur do të fillojë ndërtimi i këtyre objekteve duke marrë parasyshë që kanë qenë të planifikuara nga viti 2018..

Agnesa Vokshi- e cekta edhe me herët se ajo çka na penalizohet me punë në këto drejtim është buxheti, deri sa na kemi pasë kërkesa të shumta ku ministria nuk na ka përkrah por kërkesat prej neve kanë me qene të vazhdueshme dhe besoj se qeveria po ministria do të na mbështes.

Kryesuesi konstaton se u shterr diskutimi rreth kësaj teme dhe e qiti në votim, me 12 pro dhe 4 abstenim (VV dhe PDK), disa nuk marrin pjesë në votim.

V. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga vërshimet, breshëri, erërat, etj.

Kryesuesi e prezentoj piken pastaj tha se komisionin e kemi këtu për sqarime.

Yllarta Thaqi- une në KPF i kam dhënë vërejtjet e mia vetëm tre faqe që nuk e kemi kuptu, mirëpo tash raporti është plotë dhe nuk kam diçka tjetër që ka me shtu, sepse kam dshatë me ditë sakt kush ka aplikuar dhe kush ka fitu.

Miftar Ahmetxhekaj- realisht në e kemi një rregullore të kuvendit që përshkruan se materiali për seanca të kuvendit e ka një afat ligjor, pajtohem me Yllarten se raporti ka ardhë i mangët, mirëpo dhe ky raport nuk është profesional, ku komisioni nuk i përfillë dispozitat që ua jep vendimi, e para komisioni për çdo rast veç e veç duhet të konstatoj daljen në teren duhet të përcaktohen ekonomitë familjare, të përcaktohen kulturat edhe në arë edhe shkalla e demit.

Teuta Nesziraj –na pritem që njëri nga zyrtarët me na dhanë informata me të hollësishme ku askush nuk dhe ndonjë sqarim dhe ne po shohim se është një raport i mangët ka mungesë të teksteve të informacionit dhe nuk kemi përgjigje të sakta kur ku dhe të kush janë këto dame.

Mon Selmanaj – une isha në pak të demet në kulturat bujqesore, demet e tjera si demet nga kafshët e egra-ariu, ku në këto raport kanë ardhë të dhëna të pa mjaftueshme për vlerësim p.sh, janë dhënë numri i kerksave për misër dhe vlera në euro ku nuk është përfshi numri i hektarëve dhe emrat e përfituesve

etj, ndersa te bletet vetëm numri i kerkesave 8 ndersa personat nuk janë te perfshire se kush eshte dhe sa eshte dhe sa eshte bere kompensimi gjithashtu te numri i kërkesave per arra tri i kmei kërkesa ndërsa nuk specifikohet demi, nderate lista emrave te te dëmtuarve nga te fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqsites tjera nga viti 2023 nuk eshte specifikuar kush janë, a jan ekonomi familjare apo janë individ, ndërsa te lista e dëmtimeve familjare eshte pershkru mire

Gentiana Mazrrekaj, kerkojme falje qe nuk eshte dërguar raporti i detajuar, raporti ka gjithsej 61 fq. , sivjet na ka ardhë nje njoftim nga qeveria ku thuhet se duhet te formohet komisioni e vendim te kryetarit, komision per vlerësim te dëmeve te shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, i cili është me mandat të kryetarit, deri tash çdo drejtori e ka formu komisionin e vet per fushën e vet perkatese ndërsa tash komisioni eshte miks, nga te gjitha drejtoritë, ku janë 6 anëtar te komisionit jemi dal ne teren kemi shqyrtuara 29 kerkesa, ku na eshte dërguar nje formular nga niveli qendrorë, si komision kemi dale ne teren dhe ku janë cekura ne raport te detajuara sipas nivelit qendrorë qe ka rekomanduar.

Ndërsa material eshte vetëm dalje ne teren kur edhe formuar komisioni ndërsa nuk e kemi dërgesat raportin te terin , lista e detimeve te ekonomive familjare eshte e vitit 2022 ku e ka kërkuar Yllrata, ndërsa lista si pliteim nr i kerkesave qe kan e kerkuar janë gjithsej 29 ku janë bere fotografi dhe matje ku është bere vlerësimi ne euro.

Florim Mataj , u tha shume edhe nga koleget desha vetëm një pyetje kerksa ime do te ishte sqarim ne lidhje me nivelin qendror sa eshte përkrahja, sa kemi qene na te afte si komision me i paraqite te dhënat te niveli qendror , pyetja ime sa janë te sakta shënimet per demet qe na i kmei paraqite te niveli qendrorë..

Gentiana- qeveria ka ndarë mjete per vitin 2022, ku janë shperndar te hollat per ekonomitë familiare qe kane perfitu, ndërsa raporti qe behet fjale eshte raporti i viti 2023 ku duhet kaloj ne Asamble dhe te dërgohet ne Minsitri , dhe atje do te vendoset sa mund te përfitojnë te dëmtuarit.

Orges Tafilaj, besoj kish qene e rrugës qe te gjitha këto qe i tha Gentiana me pase me material te shkruara, realisht e mora fjalën per nje çështje tjetër se lista e tjetër e dëmtimeve familjare qe na kuni sjelle por edhe ne raste tjera kur do qe bëni raporte te kuni kujdes me shpërndarjen e te dhënave te individve , sepse sot e kemi listën dhe i kemi te dhënat e llogarive bankare te secilit person, besoj se informacione te tilla te ndishme nuk guxojnë te shpërndahen as këtu dhe as ne ndonjë vend tjetër.

Mon Selmonaj -demet e shkaktuara dhe numri i kerkesave nuk eshte dhenë arsyesheri ku te misri për shembëll i kmei 6 kërkesa dhe nuk është cekë kush është përfituesi as te dheat tjera kush eshte përfituesi, sa hektar ndërsa, kërkoj te dhëna te bletët te arrat qe janë prezentu te mangëta, per ekonomi familjare numri kërkesave 6 , kurse perfituesi nuk eshte nje shënim i sakt kush janë poerfituesit.

Gentiana – do te kemi kujdes për hera tjera sa i përket te dhënave personale, janë verifiku numri i qytetarëve që janë dëmtu, ku janë 6 raste, jemi dale ne teren i kemi verifiku dhe me formulart qe unë i kam e kemi ba matjen qe ta qet damin vet ta llogarite.

Vatan Istrefaj-pyetje, numri kërkesave ka qenë 29 poashtu ne KPF kemi ba pyetje sa nga këto kerkesa kane gjete përkrahje, poashtu na ka ardhë një listë e dëmeve te ekonomive familjare, por janë 6 raste qe janë te vitit 2022, na e kemi fjalën per këto kërkesat per vërshimet qe kane ndodhe ne vitin 2023, ku e shoh qe shum ekonomi familjare qe kane qene te parapara nuk janë në këtë listë këtu, a janë përcjellë ato kërkesa ne qeveri apo kane mbete pasi te votohen ne asamble.

Gentiana Mazrrekaj- sqaron se na i kemi pase qeto kerkesa i kemi qu ne ministri dhe te dëmtuarve ju kane dale mjetet, ndërsa lista e vitit 2023 ende nuk ka shku ne Komision qendrorë.

Yllarta Thaqi- kur e bini nje raport o kompletone o mos e bini fare, e kuni pru listën e vitit 2023 qe le per te dëshiruar, tash i kuni pru dy lista qe prap nuk po i kuptojmë, kuni pru te dhënat personale te palëve qe duhet me qenë konfidenciale, dhe tash kemi ra ne dilemë a duhet mi votu apo jo raportin sepse janë dy lista ndesh me njëra tjetrën.

Gentiana Mazrrekaj- ne KPF na u ka kerku nje liste e njerëzve qe kane perfitu, me vjen keq per qeshtjen e te dhënave personale, ndërsa listën tjetër e cila ende nuk ka shku ne qeveri na kemi punu ne baze te formularit qe na ka ardhë dhe nuk lejon te behen gabime aty.

Albesa Cacaj, a kish pasur mundësi qe te shtyhet kjo pikë nga rendi i ditës meqë ankesat ma te mëdha qe nuk jemi te paisur me material komplet, dhe te shtyhet per shqyrtim per mbledhjen e radhes.

Kryetari i komunës, se pari edhe unë i bashkona vërejtjes se raporti ka mundur te jete me i kompletuar pse është mirëpo procedura si ka ardhë deri te formimi i këtij komisioni, është sepse është marr vendim nga qeveria per formimin si komision nga te gjitha komunat e Kosoves dhe eshte me mandat te kryetarit, dhe krejt komunat kan raportuar ne qeveri, ku nuk kanë shkuar ne form te sakt nga te gjitha komunat ndërsa komuna jon jemi model per raport te sakt te dëmeve, ku ka pase komuna qe kane bere fryrje te dëmeve ku është propozuar si model komuna e Deçanit per qartësi dhe saktësi te raportit, mirëpo është mbledhja e fundit për ketë vit dhe unë kërkoj nga ju për aprovim te këtij raporti ku janë 29 ekonomi familjare për kompensim.

Miftar Ahmetxhekaj, është një pajtim i përgjithshëm se ka problem si raport, mirëpo kur behet fjalë për qytetar , unë sa e kuptova viza per tu inkasuar këto mjete eshte kuvendi, pavarësisht te gjithave une po du me besu se raporti eshte i kompletuar por ne nuk e kemi ashtu dhe vlersimi jone eshte mbi bazën e asaj qka u sqarua këtu, megjithat ne si grup po dojme me besu se ju e kini nje raport i cili ka me kaalu ne komisionin te ti e apostrofove, mbështetur ne kete apsolut ne i japim mbështetje dhe e përkrahim si te tillë, megjithatë te jete nje sygjerim ne te ardhmen te provohet qe te krijohet raport me i mirë.

Yllarta Thaqi- ne emër te grupti te AAK-së japim mbështetje, me gjith mangësitë qe u ceken, duke shpresuar se herave tjera te kemi raporte ma te mira.

Kryesuesi e qiti ne votim raportin, me Votim unanim miratohet Raporti i vlerësimit të dëmeve nga vërshimet, breshëri, erërat, etj.

VI. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave.

Orges Tafilaj, realisht prap edhe per kete kur kemi diskutuar herën e kaluar kisha një vërejtje te % qe perfitojnë konsumatorët ne rast te parapagimit, prap po them para gjashtë mujorshin nëse paguhet 5% eshte pak edhe nuk eshte ne pyetje per dike qe ta paguaj sepse eshte vetëm 1.80 euro cent, unë besoj qe kjo përqindje ose duhet te rritet ose te eliminohet.

Mon Selmonaj, në takimin e fundit qe kishim ke këshillat e fshatrave ku ishte prezent drejtori i shërbimeve publike, pjesëmarrës nuk ishin perfaqesist e kompanisë apo Ndermarrjes “Higjiena” mirëpo si përfundim erdh qe drejtori te kontakton me ta dhe te gjitha ato qe kan per te thene ata drejtori sot te na i bjen ne mbledhje, ku ne fq, 15 te faturimi i mbeturinave ku pika e par thot konsumatori obligohet te paguaj çdo muaj te vitit faturën, ndersa pika 2 thotë konsumatori obligohet te paguaj faturën e mbeturinave ne 4 keste brenda vitit si me poshtë ku përshkruhen kategoritë por me eshte dilema per cilën kategori te konsumatorit behet fjalë, a behet fjale per konsumatorit e rregullt qe kane mundësitë qe per çdo tremuaj te paguajn faturat e tyre apo eshte ndonjë kategori tjetër sociale qe i jepet mundësia te pagune çdo tre muaj, dhe pika 3 konsmatoret paguajn tarifat per menaxhimin e mbeturinave dhe sipas shumës së përcaktuar nga kuvendi, ndërsa në fillim vit ne e kemi pase nje kerkese nga Higjiena per ngritjen e tarifave te mbeturinave dhe ne si kuvend e kemi miratu tarifën prej 6 euro per amvisrite ndërsa ekzekutivi shumen prej 85 te paguhet nga ekzekutivi dhe a vlenë kjo kategori edhe për ekzekutivin nëse nuk i ka permbushe obligimet me vendimin e kuvendit apo jo, qysh specifikohet kjo.

Kryetari i komunës, mendoj qe te sqarojet nenin 25 ne vazhdim ai sqaron se normat mund ta rregullojnë pagimin e tarifave edhe me këste na e kemi marre nje vendim per tarifa dhe ne kete kohe ka qene vullnet i komunës qe nje pjese te tarifës ta barte komuna dhe ta paguan nga buxheti i komunës, kjo pagesë duhet te behet dhe kjo do te behet ne nje kohe te përshtatshme kur ka me pas buxhet komuna.

Kryesuesi e qiti ne votim (18 prezent), miratohet njëzëri.

VII. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar

Drejtori, Besnik Hulaj- sqaron se rregullorja ka per qellim motivimin e mësimdhënësve per punën e tyre, mësimdhënësi i dalluar subvencionohet ne nivel institucioni me nje shumë simbolike prej 400

euro, ne nivel komunal mësime dhënësi me i mire paguhet 800 euro, ai mesime dhene qe zgjidhet nga te gjitha shkollat nje here ne vit perfaqson Deçanin ne Prishtinë.

Yllarta- a kish qene mire qe çmimi te epet ne material shpenzues jo ne vlere monetare, me qëllim qe te shfrytëzohet per klasën e atij mësime dhënësi gjate vitit.

Drejtoi i arsimit , kjo është një rregullore qe bene përzgjedhjen e mësime dhënësin me te mire, nëse nje shkollë ankohet per material shpenzues nuk qëndron sepse shkollat furnizohen rregullisht nga një buxhet tjetër, i dedikuar per material shpenzues.

Vatan Istrefaj, pata te ndalna te ndarja e shpërblimit këtu se kjo rregullore ka qene edhe vitin e kaluar, ku shpërblimi ne nivel institucioni ka qen 150 ndersa ne nivel vendi 300, por unë kam propozu qe ai shpërblim te behet 500 dhe 1000 euro dhe po me vjen mirë qe po merren per bazë propozimet e opozitës.

Orges Tafilaj, fillimisht mire qe eshte perfshirë kriteri 4.14, sepse eshte kriter kryesor, sa i mirë eshte meismdhensi tregojnë rezultatet e nxënësve te tij e dyta qe e kamë shpreh si shqetësim edhe atëherë kur eshte shqyrtu eshte tek puna e pagese se kjo ka me qene presedent edhe per raste tjera ka me qene presedent edhe perkategoritë tjera kështu që pasi qe kjo eshte pjesë e rregullores , kur behet fjale edhe per artist dhe te tjerë duhet te merret parasyshe edhe kjo pikë per arsye se dikuj ja japim nje shpërblim financiar eshte problem pastaj per pjesn e kategorive tjera, e dyta kriteri se paku 5 vite përvojë eshte pak përjashtues per shkak se mund te vije nje mësime dhënë qe nxensit e tij janë me te mirët per 3-4 vite dhe pse ta përjashtojmë, dhe ne fund neni 8 ku ceket se nje nga antaret e komisionit eshte drejtori i institucionit edukativo arsimor mendoj se mund te vij deri te konflikti i interesit dhe ate ne dy raste, nen 1 mund te anon nga mesime dhënsi qe vjen nga shkolla e tij, ose ne rastin tjetër mund te jete modest dhe ta penalizoj mësime dhënësin e shkollës se tij.

Drejtoi- te komisionet, brenda shkollës eshte komision i DKA qe monitorin at proces .

Miftar Ahmetxhekaj, me mire si futet si kriter vlersimi i mësime dhënësit qe bene drejtoria dhe ai vlerësim te jete me standarte psh arritshmeri e larte se sa te kufizohet ne 5 vite, mund te jete mësime dhënë qe ne vitin e par te punës por qe tregon suksese, dhe ka vlerësim te larte nga drejtori i shkoles, kjokerkoj te rishikohet përndryshe pajtohem me te tjerat.

Kryesuesi e qiti në votim, antarët Kuvendit me Votim unanim e miratojnë Rregulloren për përzgjedhjen e mësime dhënësit të dalluar (19 vota).

VIII. Marrja e vendimit për hartimin e Planit rregullues për pronat e shpallura me interes public në parkun kombëtarë “ Bjeshkët e Nemura”.

Drejtori, Ramë Melaj- sqaron se Per miratim hapi i pari marrja e vendimit nga kuvendi per hartimin e planeve te detajuara, pastaj shkojmë me faza tjera, janë përcaktu hapsirat ku per te cilat do te hartohet plani, eshte plan rregullues qe do te hartohet per Bjeshkën e Belegut, qendra e skijimit në Dervishkom dhe Kampingu (Fshati ekologjik)Laku i kryqës.

Leotrim Hadegjonaj- deshta edhe pak mi plotsu drejtorin per sqarim, mi pase te qartë te gjithë, kur ka kaluar plani kombëtar i bjeshkëve te nemuna jan 7 caktuar zonat, zoan eparë , zona e dytë dhe zona e tretë ku lejohet dhe ku nuk lejohet ndërtimi sipas votim 2021 jane 16 parcelala ku ka kërkua komuna me i shti ne strategji komunale per investime edhe ne planin hapësinor kombëtar qe eshte miratu kete vit ku ja përfshi shumica prej atyre pronave, e 3 nga ato prona te cilat komuna ka kërkuar sot qe te kalojnë dhe te behet hartimi i planit rregullues per to, dhe kjo ndoshta eshte nje nga pikat ma te randsishme per zhvillimin ekonomik te Deçanit qe ka me ndodhe ne 10 vitet e ardhshme qe kërkohet nga qe per këto prona qe te behet plani rregullues hapësinor komunal.

Miftar Ahmetxhekaj, po flasim per nje kerkese ku eshte shume e drejt per komunën e Deçanit per tishfrytëzu per te mirën e qytetarve por sa kemi te drejtë tuj pasë parasyshtë e Parku Kombëtarë Bjeshkëe Nemura i trajtojnë dy dokumente, Ligji per Parkun Kombetar dhe Planit Hapsinor i miratuar së fundmi, miratimi i asambles se kaluar per shpalljen e atyre zonave me interes per komunën , sa kam njohuri per planin hapësinor komptent është Agjensioni i Kosoves, une e kam nje dilemë a biem ndesh me kete dokumentin e fundit dhe a kemi te drejt te planifikojmë si komune te bejm plan zhvillimor per ato zona, nëse po, absolut qe pajtohna dhe i japi mbështetje kësaj çështje.

Orges Tafilaj, per secilën nga këto zona na eshte dhene çka duhet te investohet aty dhe unë besoj se ne investime te tilla ne këto pjesë ndërron pamja ekonomike e Deçanit, si pyetje e para per prona te caktume qe janë cekur a ka ndonjë pretendim nga individ apo persona juridik dhe e dyta, banorët a pajtohen me investimet e cekura apo janë vetëm investime qe janë paramendu qe kan me ndodhë në të ardhmen edhe disa prej investimeve veq janë duke ndodhe aty, a janë në përputhje me ligjet aktuale.

Mon Selmonaj, është cekur këtu per dokumetet qe i janë bashkangjite kësaj kerkese, cilat kane qene arsyet e hartimit te planit hapësinor zhvillimor , apo kane qene ne pyetje çështje pa definuara ne raport me Parkun nacional, me ministrinë e Ambientit qeshtjet apo mjetet tjera fianciare te cilat ka ndikuar te mos filloj kjo procedur.

Kryetari i komunës, ndoshta vendimet do te vleresohen sipas rendesis besoj qe shte nje nga vendimet me te rendesishme per Deçanin, kemi pasur nje fatkeqësi ne vitin 2012 kur eshte shpall park nacional, ku jemi demtuar mirëpo jemi mundurar nje grup qe te hartojmë interesat e komunitetit, deri ne 2017 ku eshte marr nje vendim ku mbernda planit te parkut kombetar te jene interesat e komune se Deçanit, kemi marr nje vendin ne ket sall nga kuvendi ku i kemi shpall prona me inertes dhe kemi arrit drenda atij dokumenti ne bashkëpunim me ministrin e ambientit dhe ministrinë bujqësisë kane qen 18 parcela, nga ato 16 jane te aprovuara nga to pse na kërkojë se ky dokument duhet te jete i miratuar nga M. Ambientit dhe Bujqësisë besoj qe nëse ne arrin te përfundojmë këto plane rregullues e ne konceptin e zhvillimit ekonomik, ku kemi bere edhe nje mundësi per dokumente nga instituti i Zagrebit dhe mbi at baze do te bëjmë perpunimin e këtij dokumenti ku kryesisht janë turizmi, ideja ka qen qe nëse vjen dikush si investitor qe duhet te sqarosh se si pronar çka do te jete, ka kosto por kemi pasë komunikime me faktor te ndryshëm dhe na kanë premtua se do të na përkrahin.

Kryesuesi e qiti në votim, konstatohet qe unanimitisht 21 anëtar votojnë pro.

Pika 10. Shqyrtimi i Draft- Raportit të performancës komunale për vitin 2022

Orges Tafilaj- ne bazë të pikave që janë përmendë këtu edhe në bazë të asaj që kemi kaluar në këtë asamble dihet se ka përmirësim, krahasuar me vitin 2022, pyetja qe shtrohet këtu është për këto pikat ku ka ngecje , cilat janë hapat qe i kini marrë për përmirësimin e tyre.

Albesa Cacaj-raporti na paraqet performancen e komunës , raporti synon te pasqyron dy aspekte kryesore te punës se komunës , mënyrën e qeverisjes se komunës bazuar ne legjislacionin ne fuqi dhe ofrimin e shërbimeve ne aspektin sasiorë dhe cilësorë. Matja e performancës synon te japë përgjigje ne pyetjet se ne çfar niveli ka performuar komuna , nëse komuna po i arrinë objektivat e veta, nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin dhe cilat janë veprimet e nevojshme qe duhet te ndërmer komuna per te permirsusr kete raport . Qellimi i matjes se ketre treguesve shërben gjithashtu edhe per nevoja te te grantit te performances komunale , raporti tregon se komuna duhet ti rris përpjekjet per te përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen , nevoja ma e madhe shprehet duke filluar nga perfaqsimi gjinorë, zhvillimi ekonomik lokal, kanalizimi, planifikimi hapësinorë, menaxhimi i fatkeqsive. Unë kam bërë mbledhjen e pikëve dhe një raport krahasues nga viti 2021 dhe 2022, ky raport na tregon se komuna e Deçanit është pritë të ka progres por në fakt ka regres, zhvillimi ekonomik, shëndetësia e me radhë për te cilat ka cekë përqindjet , cilat janë masat qe komuna e Deçanit te renditet ma mirë.

Enver Cacaj, Koordinator i performances komunale, ka dhënë sqarime, kan qenë 13 fusha dhe 373 te dhëna, kemi marrë pika minus ne disa fusha sepse nuk i kemi pasë dokumentet e hartuara dhe te miratuara.

Miftar Ahmetxhekaj-pyet, te performaca uji pijes 100% a behet fjale per shtrirje te rrjetit apo shërbimet.

Vatan Istrefaj te perqindja e buxhetit per kujdes primar shendetsor, komuna jone ka nje mbeshjtetje te ulet prej 5.75 %

sepse kemi munges te jashtëzakonshme te barnave esneziale, dhe eshte mire qe buxheti te shkon edhe te barnat e listës primare.

Enver Cacaj- ka dhene sqarime, kjo kalkulohet me përqindje te buxhetit total, poashtu ka dhene edhe sqarime tjera.

XI.Pika 11. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe planit të veprimit 2023-2030,

Drejtori, Isuf Demhasaj- ka dhene sqarime rreth këtij dokumenti.

Yllarta Thaqi, edhe ne KPF i kam dhen vërejtjet rreth kësaj strategjie, kësaj radhe flas ne emër te grupit parlamentar te AAK, ju përgëzoj për punën, është një punë voluminoze, është një dokumnet qe i nevojitet komunës se Deçanit, do ta kini mbështetjen tone, vërejtjet qe i kam dhene ne KPF i kemi drejtua me shkrim po du me besu se ky dokument do te jetë ne fund te janarit i kompletuar dhe kemi me pa se çka është përmirru dhe qka është punua.

Vatan Istrefaj, ne si grup i LDK-së e mbështesim ketë strategji jemi te gatshëm te marrim pjesë në hartimin e saj, kështu që vërejtjet tona do ti dërgojmë përmes te dërguarit tonë parlamentarë.

Kryesuesi- ka sqaruar se kjo strategji i ka kaluar procedurat e shqyrtimit , ka qenë në leximin e parë, është mbajte edhe dëgjimi publik për të dhe sot është në leximim e dytë ku duhet të shqyrtohet, mund të ipen propozimet konkrete të cilat do të inkorporohen në tekst nëse aprovohen këtu dhe sot duhet të miratohet si dokument.

Ajne Iberhysaj, sqarim per strategjinë e zhvillimit ekonomik ku sqaron se ky dokument ka kaluan ne leximin e parë, është mbajte edhe dëgjimi publik, dhe sot duhet të miratohet sepse është konsumuar ku kemi marr sugjerimet sepse duhet te jete i aprovuar sepse komuna del ultë me pike dhe ne performancen komunale ku ky dokument duhet hartuar edhe në harmoni me udhëzuesin e strategjisë së lëshuar nga MAPL, kërkoj qe te kalohet dhe miratohet ne këtë mbledhje.

Orges Tafilaj, realisht besoj se duhet dëgjuar drejtorin ku cek se akoma duhet te mbetet draft dhe ka nevojë për tri punëtori , unë besoj se duhet ti ndjekim ato tri punëtori, dhe besoj se ky dokument ashtu si është nuk duhet të kaloj edhe për shkak të lekturimit edhe për shkak të mos pjesëmarrjes së një pjese të madhe të opozitës në hartimin e saj.

Mon Selmonaj, fq. 57 ku flitet për aktivitete të trashëgimisë kulturore, pika e fundit dita e majlit në muajin qershor dhe korrik a mund ta sqaroni këte, sepse dita e gështenjës është diçka tjetër mund të quhet muaji i mjaltit në muajin qershor dhe korrik por dita e mjaltit në muajin qershor dhe korrik, nuk e kam hasë kërku, a mund ta elaboroni pak.

Isuf Demhasaj, unë jam hala i mendimit se ky draft ka nevojë për përpunim, jo ë nuk është në rregull por ka nevojë për përmirësime si në këtë rast.

Florim Mataj, pyet drejtorin, a te kalohet apo te hiqet nga rendi i ditës nëqoftëse dojmë na me plotësua ndryshua diçka a ta hjekim nga rendi i ditës, sepse jemi pak në kundërthanje sepse procedurat kanë kalu ndërsa nga ana juaj kërkohet që të rregullohet si tekst me rekomandimet që po epen sot këtu dhe ish kone mirë me na sqaru pak mi pasë të kuartë edhe na.

Drejtori Isuf Demhasaj- kërkesat që i kini për ndryshim normalisht që janë të arsyeshme dhe do ti bëjmë ndryshimet.

Kryesuesi- nëse dëshironi mi shty e shtymë si dokument, por nëse votohet sot he shkon në Ministri atëherë vetëm nëse ndryshohet dhe plotësohet sepse e merr versionin përfundimtarë.

Yllarta Thaqi- atëherë nëse shkon si dokument ashtu si e kemi marrë na është shumë gabim, ma së pari prej lekturimit është shumë dobët , mandej janë shumë ndryshime që duhen mu ba brenda këtij dokumenti te cilat unë edhe me shkrim i kam dorëzua, besoj se duhet te bëhen ndryshime dhe nëse dërgohet pa plotësuar është shumë gabim, një shembull dita e dëshmorëve 15 qershori te cilën na vet e kemi shfuqizua dhe e kemi 5 dhe 6 maji, pastaj 17 shkurti, i kemi aktivitetet sportive ku janë te paktën mbi 10 aktivitete që i mbështetë zyra e Kryetarit, festivalin e fëmijëve “Ardhmëria” tri herë është mbajte, që vetëm ku duhet vendosur për ta ndryshuar dhe plotësuar ne përgjithësi, te administrata te rrugët me emërime gabim, zyret e vendit nuk ka ma sepse tash janë Gjendje Civile , zgjerone rrjetin e grupit punues dhe perpunone mirë si duhet si dokument, ndërsa tek fjalimi i kryetarit është i njëjtë te krejt dokumentet vetëm një rresht po ndërrohet.

Florim Mataj, kisha propozuar qe te votohet sot të kalohet me ndryshime dhe plotësime , te behet edhe lekturimi dhe kjo te behet për shkak te performances se komunës meqenëse po kërkohet.

Kryesuesi- edhe unë po i bashkohem propozimit të Florimit dhe po mendoj se është arsyeshme që këtë draft ta votojmë sot, me rekomandimet të cilat u jepën dhe të cilat i bashkëngjiten dokumentit përfundimtarë dhe ai dokument përcillet për ministri.

Miftar Ahmetxhekaj, dokumentet që kanë rëndësi në momentet e fundit jo qëdo gjë ka urgjencë, ky dokument ka kohë që është në shqyrtim, ku janë disa detaje që flitet për muzeun dhe rekomandimet që ne po japim nuk besoj se mund të inkorporohen kështu pa asnjë shënim zyrtarë, ka gabime si dokument, besoj se momentin që aprovohet ky e merr epitetin zyrtar, edhe në emërtimet e asetes ka gabime sepse nuk quhet ai mulli ashtu, ka një emërtim krejt tjetër edhe diçka të keni kujdes secili investim behet për të ngritur diçka jo për qëllim mi rujtë trashëgiminë, trashëgimia është diçka që ruhet brez pas brez, është ajo që përsëritet, ka nevojë për përmirësime, jamë për atë që të miratohet sepse ka një afat ligjor ku ka penalizime, por jo me na prurë me urgjencë në minutat e fundit.

Mon Selmonaj- thotë se kisha kërkuar që mos të ngutemi me i dhanë kohe drejtorit të drejtorisë për zhvillim ekonomik, me i bo ndryshim plotësimet dhe me na ardhë si dokument i pergaditur mirë në mbledhjen tjetër, sepse kush na bindë neve si kuvend se rekomandimet tona kanë hy në atë dokument.

Florim Mataj- të miratohet sot, ndërsa për të gjitha ato rekomandime që u dhanë drejtori e ka hapsirën me i ikorporu në tekst.

Drejtori Isuf Demhasaj- na jemi në një vi krejt, kështu që kërkoj nga ju ta miratojmë me rekomandimet që u dhanë .

Kryesuesi e qiti në votim me rekomandimet që jepën, me Vota 16 pro 2 apbestenim kalon Strategjia për zhvillim ekonomik lokal dhe plani i veprimit 2023-2030, me rekomandimet që u dhanë.

XII. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024,

Leotrim Hadergjonaj, është si dokument i mangët ku mungojnë fletat poseduese dhe kopjet e planit, për dallim nga seanca e fund viti të kaluar ku kanë ardhë në material dhe kopje të mjaftueshme.

Kjo është pike që besoj se duhet patjetër kaluar për shkak të investimeve të ndryshme propozoj që herëve tjera të sillen komplet materiali.

Vatan Istrefaj, kemi mungesë si dokumentacion i mangët si ortofoto, kopja e planit etj, si grup parlamentar kemi vërejtje.

Orges Tafilaj, lista që na ka ardhë besoj se edhe kolegt e kanë të njëjtën, për piken 12 të data shkruan 20. 12.2022, dhe a është përmirësua kjo listë apo na ka ardhë ajo e vitit të kaluar.

Mon Selmonaj, mos prezenca e drejtorit të kadastrit apo ndonjë zyrtari me na i elaboru ato që po kërkojmë, mendoj se është një hendikep i madh për ne, i bashkëngjitem vërejtjeve të parafolëseve ku është një gabim në data dhe vit ku mundon kompletimi i materialit, janë 2 parcela me vite të tera që na vjen për miratim në vitin e kaluar kemi ngrit një thirrje për dhënien në shfrytëzim për dhënie të pronave pse dy prona në Rastavicë dhe Drenoc nuk po epen në shfrytëzim, për këtë kërkon sqarim nga kryetari.

Kryetari i komunës, për pronën në Rastavicë jeni në përfundim të procedurës sepse janë aspekte procedurale ndërsa për Drenoc kemi pas oferta të ndryshëm mirëpo që nuk e kemi shikuar që të epet për qëllimin që ka qene nga ofertuesit., ku ka qen kërkesë për efiqieinc mirëpo nuk ka mundur të arrihet qëllimi ndërsa prona tjetër është e procedurë e përfunduar deri në nënshkrimin e tyre.

Flortim Mataj, është një liste që duhet votuar sepse është obligim ligjor ku dihet se komuna jone i posedon këto prona, ndërsa listat poseduese dhe plani duhet të prezantohen në momentin që zhvillohet procedurë dhe e tregon dikush interesin.

Kryesuesi e qiti në votim, 13 pro 7 abstenim (LDK, PDK LVV).

XIII. Marrja e Vendimit përfundimtar për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë, parcela nr.0429-0, Zk.Deçan, aprovimi i ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues.

Kryetari i Komunës ka dhënë sqarime.

Fekri Qufaj, kryesues i komisionit- raportin e kuni, ju ftoj qe ta votoni se sipas raportit janë te gjitha dokumentet.

Miftar Ahmetxhekaj, mbështes punën e komisionit duke pasë parasysh shpesh dokumentet nuk na vijnë paraprakisht dhe është mirë te na vinë me kohë dhe të kompletime, na e kemi një dokument qe ka ardh sot, sepse ka qene komplet materiali i mbledhjes voluminoz, ku si dokument ish dashtë te jetë ma i kompletuar, dhe ne për shkak se dokumenti nuk është i plotë dhe ka ardhë me vonesë na për këtë seancë nuk i japim mbështetje.

Orges Tafilaj, konsideroj qe jashta raportit është dashur qe këtij dokumentacioni ti bashkëngjiten edhe projekti ideorë për shkak se ne i kemi dy projekte se pari podi i gështenjës dhe hudhrës se peshqve, prandaj kërkon sqarim nga kryetari i komisionit qe se paku te na tregon se qka ka mu investu këtu në këtë pronë.

Mon Selmonaj, e një pyetje për investitorin , cili do të jetë investimi i tij sepse shuma qe ai ka ofruar për investime është eshtë një shume prej mbi 1,442,500.00€, si dhe çmimi e një 1 ari prej 110 euro, prej kurë fillon dhe për sa vite është.

Fekri Qufaj, te gjitha kanë qene publike , si ne faqen e komunës si dhe çdo gjë ka qen transparent.

Kryetari i komunës, falënderim për komisionin dhe punët e tyre, besoj se çdo gjë ka shkuar ne mënyrën e parapare ligjore.

Orges Tafilaj, qasje kemi ne dokumentacion çdo njeri prej neve, mirëpo besoj dhe kërkoj qe komisioni duhet te na japë përgjigje, pa marrë parasysh a është dokumentacioni diku a nuk është, poashtu besoj s projektin ideorë është dashtë mi pasë sot këtu nëse kemi për ta votu, kryetar edhe njëherë po ju pyes prona do të shfrytëzohet për agroturizëm apo për çka.

Kryetari i komunës, prona do te shfrytëzohet për agroturizëm.

Kryesuesi e qiti në votim, me 12 vota pro, 5 abtenim, kundër 1, miratohet .

XIV-Të ndryshme.

Orges Tafilaj –fillimisht na është premtua ma tepër se një muaj se do të zgjidhet problemi i kamerave në shkollën fillore Lëbushë dhe njëkohësisht zgjidhja e problemit të qasjes me internet të shkollës, e dyta kurë do të fillon ndërtimi i rrugës nga Lëbusha deri në Strelc, dhe si është parapa të zgjidhet problemi i kanalizimeve ose gropave septike që janë afër rrugës dhe njëkohësisht përderi sa prroi i fshatit kalon mes fshatit a është parapa ndonjë investim në këtë kohë apo është shty për ma vonë

Kryetari i komunës, për shkollë në Lëbushë jemi në përfundim të këtyre punëve, sa i përket rrugës Lëbushë- Strelc besoj qe nga muaji mars ne bashkëpunim me ministrinë ku do te kemi dy projekte dhe nje investim edhe për këtë rrugë edhe për Isniq ku kjo rruge e ka një kosto te larte për arsye te rrugës anësore tek Lebusha dhe ku ne disa vende do te ketë disa ura ne ketë projekt parashihet te rregullohet edhe pjesa e lumit qe mos te rrezikohet pjesa e urës qe do te ndërtohet, por aty preket pak edhe prona private.


Miftar Ahmetxhekaj, kisha një kërkesë te komunitetit te këshillit te fshatit kërkoj për një enterier për zyre që i kemi në qendër të fshatit, dhe do te bej një kërkesë e cila është 1800 deri ne 2200 euro, mundësisht për shkak si fshat i madh kërkoj qe te realizoni brenda mundësive buxhetore.

Kryetari- urime viti i ri 2024.

Kryesuesi- njoftoj se gjatë janarit do ta kemi një punëtori, urime viti i ri, shnet e të gjitha te mirat, me kaq kryesuesi e shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit.

Procesmbajtëse

Dyke HOLLUNI



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

